



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 dhjetor 2023  
Nr.ref.: RK 2307/23

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI162/22**

Parashtrues

**Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Njoftimit [KMLC. nr. 83/2022] të Prokurorisë së Shtetit të 27 shtatorit 2022  
dhe Aktvendimit [Ac. nr. 1986/2020] të 20 qershorit 2022 të Gjykatës së Apelit**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), që përfaqësohet nga Veton Dragidella zyrtar ligjor në departamentin ligjor pranë Raiffeisen Bank.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac. nr. 1986/2020] të 20 qershorit 2022 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C. nr. 118/16] të 13 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe Njoftimit [KMLC. nr. 83/2022] të Prokurorisë së Shtetit të 27 shtatorit 2022.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përmes së cilave pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [ E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 20 tetor 2022, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 tetor 2022, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës solli autorizimin për përfaqësim pranë Gjykatës.
8. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr. GJR. KI162/22] caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban, anëtarë.
9. Më 31 tetor 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Gjykata po ashtu njoftoi palën e interesuar R.G dhe i ofroi mundësinë për të paraqitur komentet e tij.
12. Më 3 korrik 2023, përfaqësuesi i palës së interesuar R.G paraqiti komentet, ku ndër të tjera theksoi: *“Parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik ne procedurën kontestimore. Po ashtu parashtruesi i kërkesës me as një prove nuk ka argumentuar se i është drejtuar me kërkesë me shkrim Prokurorit të Shtetit, qe ky i fundit te veproj sipas nenit 246 te LPK-se. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur te gjitha mundësit ligjor qe njëherë paraqesin mjet juridik sipas thirrjes qe bene neni 113 paragraf 7 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës”.*
13. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Bazuar në shkresat e lëndës, më 20 tetor të vitit 2006, paditësi R.G., në cilësi të debitorit solidar përkatësisht garantuesit pagues për kredimarrësin kryesor “Toni Com” përfaqësuar nga F.G dhe parashtruesja e kërkesës në cilësi të kredidhënësit kishin nënshkruar marrëveshjen për kredinë me numër 200620647 në shumë prej 25.000 € (njëzetë e pesë mijë) euro.
15. Më 7 shkurt 2008, parashtruesja e kërkesës pas vonesës së kthimit të kredisë nga ana e kredimarrësit, parashtron propozim për përmbarim pranë Gjykatës Komonale në Lipjan.
16. Më 4 shtator 2008, Gjykata Komonale përmes Aktvendimit [E. nr. 121/2008] e lejon propozimin për përmbarim të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës.
17. Më 28 mars 2013, parashtruesja e kërkesës bllokoi llogarinë e garantuesit solidar R.G, ku kishte bllokuar shumën e mjeteve prej 1,953.36 (njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre euro e tridhjetë e gjashtë cent).
18. Më 16 mars 2016, garantuesi R.G kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër parashtrueses së kërkesës, ku kishte kërkuar që padia e tij të aprovohet dhe të vërtetohet se e paditura Raiffesen Bank pa bazë juridike, me 28 mars 2013, ka fituar shumën prej 1,953.36 (njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre euro e tridhjetë e gjashtë cent) nga paditësi, dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthejë shumën e lartpërmendur si fitim pabazë me kamatë ligjore nga data 28 mars 2013 kur ka bërë tërheqjen e këtyre mjeteve si fitim pa bazë deri në kthimin e tyre, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës.
19. Më 13 nëntor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 118/16]: (i) aprovoi kërkesëpadinë e paditësit R.G kundër parashtrueses së kërkesës si të bazuar; (ii) detyroi parashtruesen e kërkesës që paditësit t’ia kompensojë shumën prej 1,953.36 (njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre euro e tridhjetë e gjashtë cent) në emër të fitimit të pabazë për shkak të tërheqjes së këtyre mjeteve në llogarinë bankare të paditësit me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % nga data e hartimit të ekspertizës financiare 13 dhjetor 2018 e deri në pagesën definitive; (iii) obligoi parashtruesen e kërkesës që paditësit t’ia paguajë në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 1,324,40 euro.

20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i kontestuar ndërsa padia e ushtruar të refuzohet si e pabazuar, apo të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
21. Më 20 qershor 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1986/2020] e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 118/16] të 13 nëntorit 2019 e vërtetoi.
22. Më 23 gusht 2022, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 245 par. 1 dhe neni 247 par. 1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006.
23. Më 27 shtator 2022, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC. nr. 83/22], e njoftoi parashtruesen e kërkesës se nuk ka bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Ac. nr. 1986/2020] e 20 qershorit 2022 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C. nr. 118/16] e 13 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore dhe Njoftimin [KMLC. nr. 83/22] e 27 shtatorit 2022 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta Për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
25. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, pasi që siç pohon ai gjykatat kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, ku thekson se *“Duke e kundërshtuar ne tërësi aktgjykimin me numër C.nr.118/16 te datës 13.11.2019 si dhe aktgjykimin e Gjykatës se Apelit me numër Ac.nr.1986/2020 te datës 20.06.2022 pasi qe ne shkresat e lendes figuron qe paditësi ka nënshkruar kontratën e kredisë ne cilësinë e garantuesit personal apo solidar për kredi marrësin kryesor andaj edhe ne procedurën e përmbarimit si kreditor kemi vepruar konform dispozitave te LPP-se pasi qe bazuar edhe ne te drejtën materiale konkretisht ne normën e nenit 1016 te LMD-se nënshkruesi i kësaj kontrate e këtu paditësi ka cilësinë e debitorit solidar, mbi bazën e kësaj kreditori e ka bllokuar llogarinë e tij, po ashtu këto veprime janë ndërmarrë edhe mbi bazën e kontratës se kredisë duke ju referuar nenit 5 te kontratës dhe nenit 10 shkronja a).f).d). h), ku palët kontraktuese kane qene te njohura me te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e kredisë si dhe fale procedurës se filluar përmbarimore te cilën procedure e kishte lejuar Gjykata Komunale ne Lipjan”. Sipas parashtrueses nuk qëndron argumenti se është vepruar pa procedurë ligjore sepse rasti ishte iniciuar me propozim të Gjykatës Komunale në Lipjan dhe atë me datë 7 shkurt 2008 dhe i cili propozim ishte lejuar përmes aktvendimit [E. nr. 121/2008] të 4 shtatorit 2008. Sipas parashtrueses së kërkesës, *“baza materialo juridike për bllokimin e mjeteve ishte neni 267 e drejta e retencionit nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve”*.*
26. Tutje parashtruesja e kërkesës thekson se *“në rast se kredimarrësi nuk i përmbush detyrimet e tij sipas afateve të parapara me këtë marrëveshje, nuk do të kërkohet*

nga kredidhënësi të realizoj ndonjë të drejtë kompensim ose të marr ndonjë veprim ligjor kundër kredimarrësit ose ndonjë personi, entiteti apo kolaterali tjetër, para se të kërkoj nga bashkëkredimarrësi/garantuesi ta korrigojë shkeljen e marrëveshjes, ndërsa në paragrafin h) përcaktohet: bashkëkredimarrësi- garantuesi apo kolaterali tjetër, para se të kërkojë nga bashkëkredimarrësi / garantuesi e autorizon bankën që të ngarkoj llogarinë e tij tek kredidhënësi më numër si dhe në llogaritë që ka në bankat tjera të cilat janë në emër të tij, pa i dhënë njoftim paraprak garantuesit, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të garantuesit siq është përshkruar në këtë marrëveshje bashkëkredimarrësi/garantuesi nuk do të kontestoj ose kundërshtojë çfarëdo ngarkese të llogarisë në bazë të këtij neni”. Gjithashtu parashtuesja e kërkesës i referohet rregullores për regjistrin e kredive së Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 1.13, në të cilin theksohet “se bashkëkredimarrës nënkupton një person fizik ose një entitet juridik i cili merr përsipër një detyrim kreditor me një person fizik ose juridik ndërsa në nenin 1.14 përcaktohet se garantues nënkupton një person fizik ose juridik i cili merr përsipër detyrimin ligjor të kthimit të kredisë në rast të dështimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi e në lidhje me dispozitat nga neni 1016 të LMD-së nënshkruesi i kësaj kontrate e këtu paditësi ka cilësinë e debitorit solidar”.

27. Parashtuesja e kërkesës më tej pretendon edhe shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht shkelje të neneve 160.4 dhe 182.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe se aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë elementet esenciale të kërkuara me këto nene të LPK-së, ku thekson se “Dispozita 160 LPK-se parasheh në mënyrë taksative elementet e arsytimit i cili, sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqet pjese përbërëse detyruese për secilin aktgjykim. Sipas paragrafit 4 të Nenit 160 të LPK-se, arsytimi i aktgjyimit duhet të përmbajë elementet vijuese: “kërkesat e palëve, faktet që i kane parashtruar dhe provat që i kane propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me ane të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.” me tej konsiderojmë se kjo dispozite ligjore paraqet elementin me të rëndësishëm të aktgjyimit pas diapozitivit dhe, në të vërtetë, është pjesa e aktgjyimit e cila i jep legjitimitet vet diapozitivit si dhe gjykatës e cila ka vendosur mbi këtë çështje pasi që vetëm nëpërmjet kësaj pjese të aktgjyimit palët e përfshira në procedure dhe publiku mund të konstatojnë se janë dëgjuar dhe se aktgjykimi është nxjerre në pajtim me kërkesat kushtetuese dhe ligjore për një gjykim të drejtë”.
28. Më tej, parashtuesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre, ku theksoi se “Pra pretendimi fillestarë për falsifikim të nënshkrimit si dhe deklarimi nën betim i paditësit se bashku me të autorizuarin e tij si konsumim i veprave penale gjate kësaj procedure edhe përkundër kërkesave të paditësit kjo nuk ishte shqyrtuar fare nga Gjykata Themelore as edhe nga ajo e Apelit edhe pse vazhdimisht ishte kundërshtuar si dhe e paditura kishte kërkuar ndërprerjen e procedurës kontestimore duke pasur parasysh akuzën për vepër penale të falsifikimit të nënshkrimit qka edhe Agjensionin për Forenzik e kishte hedhur poshtë gënjeshtrenë e paditësit ndërsa dy instancat gjyqësore këtë fakt e injoruan duke shkelur në tërësi nenin 3.3 të Ligjit Per Procedurën Kontestimore në lidhje me nenin 7 të LPK-se”. Lidhur me këtë parashtuesja e kërkesës i referohet komentarit të LPK-së, ku siç pohon ai theksohet se mos arsyetimi i një vendimi meritator paraqet shkelje esenciale me rëndësi absolute, ashtu siç parashihet me nenin 182 paragrafi 2 nën paragrafi (n) i LPK-së.
29. Tutje lidhur me mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore, parashtuesja e kërkesës thekson se secila palë ka të drejtë në arsyetim, dhe se mosrespektimi i kësaj kërkesë ligjore paraqet edhe shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pra në arsyetim duhet të ceken të

gjitha provat e prezantuara nga ana e palëve dhe po ashtu të jepen të dhënat lidhur me vlerësimin dhe konstatimin e secilës provë veç e veç. Lidhur me këtë parashtruesja e kërkesës thekson se “Aktgjykimi i Kontestuar, dhe e gjithë procedura kontestimore që i ka paraprirë nxjerrjes së te njëjtit, ka dështuar që të shqyrtoje dhe të adresojë pretendimet thelbësore/kryesore të të Paditurës që ishin të domosdoshme për vendosjen meritore dhe të drejta të kësaj çështje juridike”. Në këtë mënyrë, parashtruesja e kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi që aktgjykimi i kontestuar nuk përmban arsye koherente mbi të cilat është nxjerrë e drejta e palëve në procedurë për një vendim të arsyetuar në mënyrë koherente, dhe se e drejta për aktgjykim të arsyetuar është thelbi dhe esenca e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

30. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [C. nr. 118/16] e 13 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore, Aktgjykimin [Ac. Nr. 1986/20] të 20 qershorit 2022 të Gjykatës së Apelit, dhe Njoftimin [KMLC. Nr. 83/2022] e 27 shtatorit 2022 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim në Gjykatën Themelore.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

[...]

### **Pranueshmëria e kërkesës**

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

#### **Neni 113**

#### **[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]**

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

[...]

33. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

34. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkëlqeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. [KI41/09](#), parashtruesi i kërkesës Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe [KI35/18](#), me parashtrues “Bayerische Versicherungsverband”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
35. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.*

36. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ac. Nr. 1986/20] e 20 qershorit 2022 të Gjykatës së Apelit Aktgjykimin [C. nr. 118/16] të 13 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore dhe Njoftimin [KMLC. Nr. 83/2022] të 27 shtatorit 2022 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
37. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e

pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.*

38. Në këtë aspekt, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret Njoftimi [KMLC. Nr. 83/2022] i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i 27 shtatorit 2022 ishte mjet efektiv lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje kushtetuese. Përgjigja në këtë pyetje do të jetë vendimtare për vlerësimin nëse kërkesa e parashtrueses të kërkesës i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 34 (2) të Rregullores së punës.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastin konkret, procedura ndaj parashtrueses së kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta ishte zhvilluar para dy instancave gjyqësore, Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, që kishte rezultuar me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. Nr. 1986/20] të 20 qershorit 2022.
40. Pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me propozimin që kjo e fundit të paraqesë, në emër të parashtrueses të kërkesës, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se kjo kërkesë është plotësisht diskrecionale për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (shih rastin e Gjykatës [KI234/21](#), parashtrues N.P.N “Çlirimi”, Aktvendim për papranueshmëri i 27 qershorit 2022, paragrafi 40).
41. Në këtë aspekt, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ nuk kërkon që mjetet juridike diskrecionale, apo mjetet juridike që nuk janë drejtpërdrejt në dispozicion të parashtruesve dhe që varen nga ushtrimi i diskrecionit nga ndërmjetësi, siç është rasti me kërkesën para Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, duhet të shteren para se parashtruesit e kërkesave t'i drejtohen GJEDNJ-së (shih mutatis mutandis rastin e [GJEDNJ-së X dhe të tjerët kundër Letonisë](#), Vendim i 6 qershorit 2008, paragrafi 20, dhe referencat e cekura aty; shih po ashtu rastin e Gjykatës [KI174/20](#), me parashtrues DE-KO SH.p.k, Aktvendimi për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 38).
42. Më konkretisht, lidhur me propozimet e ngjashme, siç është propozimi që bëhen para Zyrës së Prokurorit të Shtetit, duke kërkuar që ky i fundit të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para organeve gjyqësore në emër të parashtruesve të kërkesave, GJEDNJ kishte trajtuar në rastin Lepojić kundër Serbisë. Në këtë rast, GJEDNJ kishte vlerësuar nëse propozimi i paraqitur para prokurorit të shtetit duke kërkuar që ky i fundit të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet efektiv, ku kishte deklaruar se “[GJEDNJ] gjen se është vetëm prokurori i shtetit ai që mund të dorëzoj [kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë] në emër të parashtruesit, dhe, për më tepër, ky i fundit ka diskrecion nëse dëshiron të bëjë një gjë të tillë. Përderisa parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë një veprim të tillë të prokurorit, ai nuk ka të drejtë sipas ligjit për të përdorur një mjet të tillë juridik [kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë] personalisht [...] Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, për këtë arsye, ishte jo efektive [...]” (shih rastin e GJEDNJ-së [Lepojić kundër Serbisë](#), aplikimi nr. 13909/05, Aktgjykim i 6 nëntorit 2007, paragrafi 54; po ashtu shih rastin e Gjykatës [KI174/20](#), cituar më lartë, paragrafi 39).



43. Po ashtu, duke u thirrur në këtë praktikë gjyqësore (rastin e GJEDNJ-së Lepojić kundër Serbisë), GJEDNJ në rastin Stojanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë nuk kishte marrë për bazë njoftimin e prokurorit të shtetit për qëllim të llogaritjes së afatit, kur ky i fundit kishte konstatuar se nuk kishte bazë të mjaftueshme për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme të Maqedonisë. GJEDNJ në këtë rast kishte theksuar se *“kërkesa e parashtruesit para prokurorit publik, nuk ishte mjet që duhej të shterej për qëllime [KEDNJ]. Rrjedhimisht, periudha kohore për të përdorur atë mjet juridik nuk e ndal rrjedhjen e afatit gjashtë (6) mujor [për të paraqitur kërkesë para GJEDNJ lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit]”* dhe rrjedhimisht, GJEDNJ gjeti se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë (shih rastin e GJEDNJ-së [Stojanovski kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), aplikimi nr. 1431/03, Vendim i 22 tetor 2009).
44. Megjithatë, Gjykata rikujton që praktika e saj gjyqësore, njeh edhe raste në të cilat është vlerësuar kushtetutshmëria e njoftimeve të Prokurorit të Shtetit përmes së cilit nuk është pranuar kërkesa e palëve për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në favor të tyre. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të saj nr. [KI42/18](#), parashtruese Asija Muslija, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2020, i cili kishte vlerësuar pretendimet e parashtrueses për shkelje kushtetuese ndaj Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, mbështetur edhe në rastin e GJEDNJ [Gorou kundër Greqisë](#) (Nr. 2), aplikimi nr.12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009.
45. Megjithatë, rasti i lartcekur, KI42/18, dallon nga rasti konkret. Në këtë kontest, Gjykata rikujton se në rastin e lartcekur, KI42/18, parashtruesja e kërkesës kishte kontestuar specifikisht Njoftimin KMLC nr. 09/2018 e Prokurorit të Shtetit të 2 marsit 2018, duke argumentuar se si ky Njoftim kishte shkelur të drejtat e saj kushtetuese, që ndërlihdeshin, mes tjerash, edhe me mungesën e arsytimit të pretenduar të Njoftimit të kontestuar të Prokurorit të Shtetit. Ndërsa lidhur me Aktvendimit AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës të 8 dhjetorit 2017, që po ashtu ishte kontestuar në rastin KI42/18, si pretendim kryesor ishte mosvërtetimi i faktit nga Gjykata e Apelit se parashtruesja e kërkesës nuk e kishte nënshkruar Kontratën për Hipotekën të 2 dhjetorit 2011. Kërkesa e parashtrueses të kërkesës së rastit KI42/18, lidhur me Aktvendimin AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit ndaras nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit, ishte paraqitur në Gjykatë po ashtu brenda afatit të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës.
46. Ndërsa, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.
47. Gjykata vëren se këto pretendime ishin shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe jo nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Kjo e fundit, në fakt, kishte vendosur vetëm nëse janë plotësuar kushtet ligjore që të paraqitet një kërkesë e tillë në Gjykatën Supreme.
48. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në Njoftimin [KMLC. nr. 83/22] e 27 shtatorit 2022, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit informoi parashtruesen e kërkesës se ishte refuzuar propozimi i saj për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 118/16] të 13 nëntorit 2019 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1986/2020] të 20 qershorit 2022, pasi konsideroi se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të

parapara me Ligjin e Procedurës Kontestimore përkatësisht sipas dispozitës së nenit 247.1 pika a) dhe pika b).

49. Prandaj, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata rikujton se, në rastin konkret, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Prokurorit të Shtetit, përveç që është në diskrecionin e këtij të fundit, do të mund të ngritët nga Prokurori i Shtetit vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara ligjore. Gjithashtu, pretendimet e parashtrueses të kërkesës kanë të bëjnë më menyrën se si Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë zbatuar ligjin kur kanë vendosur lidhur me ligjshmërinë e Urdhrit të përmbarimit dhe statusin ligjor të faturave të kontestuara. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës nuk paraqet pretendime specifike lidhur me Njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, por paraqet para Gjykatës të njëjtat pretendime që i paraqet ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. Nr. 1986/20], pretendime, të cilat Zyra e Kryeprokurorit nuk ka pasur juridiksion t'i adresojë sepse ajo vetëm ka kompetencë të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme dhe jo të vlerësojë shkeljet ligjore të bëra nga Gjykata e Apelit. Prandaj, lidhur me këto pretendime, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, [Ac. Nr. 1986/20] e 20 qershorit 2022, asgjë nuk e ka ndaluar atë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.
50. Prandaj, Gjykata vlerëson se “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit, lidhur me procedurat që janë zhvilluar në gjykatat e rregullta, konsiderohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1986/2020] i 20 qershorit 2022, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtrueses të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 118/16] të 13 nëntorit 2016. Atëherë Gjykata do të vlerësojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1986/2020] lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës.
51. Gjykata rikujton se rregulli 34 (2), bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), me parashtrues: *Ajencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
52. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo

posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

53. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, sa i përket vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
54. Rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me padinë e ngritur kundër parashtrueses së kërkesës nga ana e paditësit R.G, i cili ishte garantues solidar për një kredimarrës pranë parashtrueses së kërkesës, dhe të cilit parashtruesja e kërkesës ia kishte bllokuar llogarinë bankare dhe i kishte tërhequr shumën prej 1,953.36 euro. Paditësi R.G kishte paraqitur padi kundër parashtrueses së kërkesës, me bazë juridike Fitimi i pabazë ku kishte kërkuar që të obligohet e paditura që t'ia kthejë shumën e caktuar prej 1,953.36 euro me kamatë ligjore nga data 28 mars 2013 kur ka bërë tërheqjen e mjeteve e deri në kthimin e tyre. Gjykata Themelore kishte aprovuar kërkesë padinë e paditësit R.G dhe kishte detyruar parashtruesen e kërkesës që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 1,953.36 euro në emër të fitimit të pabazë, për shkak të tërheqjes së këtyre mjeteve në llogarinë bankare të paditësit, me kamatë prej 8 % nga data e hartimit të ekspertizës financiare me datë 13 dhjetor 2018 e deri në pagesën definitive, po ashtu e kishte obliguar që t'i paguante edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,324.40 euro. Parashtruesja e kërkesës ishte ankuar në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit kishte refuzuar ankesën si të pathemeltë, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore e kishte vërtetuar. Parashtruesja e kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozimin për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, mirëpo nga kjo e fundit ishte njoftuar se nuk ka bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
55. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës në esencë ka të bëjë me (i) mënyrën e vërtetimit të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit material; dhe (ii) mos-arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë këto pretendime në pajtueshmëri me praktiken gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

*(i) Përkitazi me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit*

56. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ngre pretendimin se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht shkelje të neneve 16.4 dhe 182.2 të LPK-së, pasi që, siç pohon ai aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë

elementet esenciale të kërkuara me këto nene të LPK-së, ku lidhur me këtë thekson se “Dispozita 160 LPK-se parasheh në mënyrë taksative elementet e arsytimit i cili, sipas paragrafit 1 të po këtij neni, paraqet pjesë përbërëse detyruese për secilin aktgjykim. Sipas paragrafit 4 të Nenit 160 të LPK-se, arsytimi i aktgjykimit duhet të përmbajë elementet vijuese: “kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me ane të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”. Me tej konsiderojmë se kjo dispozite ligjore paraqet elementin me të rëndësishëm të aktgjykimit pas diapozitivit dhe, në të vërtetë, është pjesë e aktgjykimit e cila i jep legjitimitet vet diapozitivit si dhe gjykatës e cila ka vendosur mbi këtë çështje pasi që vetëm nëpërmjet kësaj pjesë të aktgjykimit palët e përfshira në procedurë dhe publiku mund të konstatojnë se janë dëgjuar dhe se aktgjykimi është nxjerre në pajtim me kërkesat kushtetuese dhe ligjore për një gjykim të drejtë”.

57. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga gjykatat e rregullta.
58. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për atë sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjjazar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva*, *Afërdita Deva* dhe *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
59. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rastin [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
60. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se efektet e interpretimit dhe të zbatimit të së drejtës materiale janë jokompatibile me të drejtat e garantuara me Kushtetute dhe KEDNJ. Për më tepër, nga arsytimi i aktvendimit të kontestuar vërehet qartë se në rrethanat e rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me “aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar” dhe as me “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme”.

61. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të rregullta janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

(ii) Përkitazi me pretendimin për vendim të paarsyetuar gjyqësor

62. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimet e tij, ku thekson se “... pra pretendimi fillestarë për falsifikim të nënshkrimit si dhe deklarimi në betim i paditësit se bashku me të autorizuarin e tij si konsumim i veprave penale gjate kësaj procedure edhe përkundër kërkesave të paditësit kjo nuk ishte shqyrtuar fare nga Gjykata Themelore as edhe nga ajo e Apelit edhe pse vazhdimisht ishte kundërshtuar si dhe e paditura kishte kërkuar ndërprerjen e procedurës kontestimore duke pasur parasysh akuzën për vepër penale të falsifikimit të nënshkrimit çka edhe Agjensioni për Forenzik e kishte hedhur poshtë gënjeshtren e paditësit ndërsa dy instancat gjyqësore këtë fakt e injoruan duke shkelur në tërësi nenin 3.3 të Ligjit Per Procedurën Kontestimore në lidhje me nenin 7 të LPK-se”. Pra sipas parashtruesit të kërkesës “Aktgjykimi i Kontestuar, dhe e gjithë procedura kontestimore që i ka paraprirë nxjerrjes se të njëjtit, ka dështuar që të shqyrtoje dhe të adresojë pretendimet thelbësore/kryesore të të Paditurës që ishin të domosdoshme për vendosjen meritorë dhe të drejte të kësaj çështje juridike”.

63. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet Hadjianastassiou kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#) nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani](#) kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; Higgins dhe të tjerët kundër Francës, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#) nr.30544/96 , Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Suominen kundër Finlandës](#) nr.37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#) nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005). Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues Naser Husaj, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues Muharrem Blaku dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës IF Skadiforsikring, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin [KI230/19](#), parashtrues Albert Rakipi, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

64. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastet e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).

65. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna

duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; [Hiro Balani](#) kundër Spanjës nr.18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; shih po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16, parashtrues IKK Classic](#), të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin [Moreira Ferreira kundër Portugalisë](#), Aktgjykim i 5 korrikut 2011, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI195/20](#), parashtrues Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jobankar "Monego", Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).

66. Gjykata me këtë rast rikujton se parashtruesja e kërkesës i kishte bllokuar xhirollogarinë paditësit R.G, dhe nga ai kishte tërhequr shumën prej 1,953.36 euro, me arsyetimin se ishte garantues i kredimarrësit "Toni Com" nga Lipjani.
67. Gjykata e shkallës së parë, kur aprovoi padinë e paditësit R.G kundër parashtrueses së kërkesës në emër të fitimit të pabazë dhe e detyroi t'ia kompensojë shumën prej 1,953.36 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e hartimit të ekspertizës financiare të 13 dhjetorit 2018 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,324.40 euro, kishte theksuar si në vijim:

*"Gjykata pas administrimit të provave, dhe atë marrëveshjes mbi kredinë e lidhur në mes të paditurës Raiffiesen Bank dhe "Toni Com" nga Lipjani, pasqyrës bankare për tërheqjen e mjeteve nga e paditura, ekspertizës së Agjencisë Kosovare të Forenzikës e të cilave ua fal besimin e plotë si prova të besueshme, gjene se paditësi Ruzhdi Gashi nga Lipjani ka qenë garantues me kolateral në automjetin "Opell Korsaa", gjithashtu vërtetohet fakti se e paditura ka bërë tërheqjen e mjeteve nga llogaria bankare e paditësit në shumë prej 1,953.36.-€, me dt.28.03.2013, pa përfillur procedurën ligjore përmes organit kompetent-gjykatës kompetente për ekzekutimin, sekustrimin dhe shitjen e kolateralit në rast të mos përmbushjes së kredisë nga garantuesi solidar. E paditura me rastin tërheqjes së mjeteve në shumë prej 1,953.36.-€ nga llogaria bankare e paditësit ka vepruar në kundërshtim me marrëveshjen mbi kredinë nr.200620647 të dt.20 tetor 2006 bazuar në nenin 10 shkronja k, në të cilën parashihet se në rast se kredi marrësi nuk respekton marrëveshjen, kredidhënësi sipas dëshirës së tij të lire ka të drejtë për dëmshpërblim-kompensim të mëposhtme, duke iniciuar procedurën e përmbarimit me qëllim të shitjes së kolateralit të lenë pengë ose hipoteke për të përmbushur obligimet e papaguara nga kjo marrëveshje dhe marrëveshjes mbi hipotekën. Gjithashtu e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 79 al.l. pika 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili parashihet "përmbarimi për sendet e luajtshme behet me ane të sekustrimit, vlerësimit dhe regjistrimit të tyre, si dhe me shitjen e sendeve të këtilla. Nga shumat e fituara me ane të shitjes përmbushet kredia e propozuesit të përmbarimit". Në pikën 2 parashihet "me ane të propozimit për përmbarim mund të kryehet vetëm kryerja e sekustrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme, por në raste të këtilla propozuesi i ekzekutimit ka të drejtë që ta parashtrorë kërkesën për shitjen e tyre vetëm brenda afatit prej 3 muajve nga dita e sekustrimit dhe vlerësimit të kryer". Bazuar në provat e administruara, faktet e vërtetuara gjykata gjene se kërkesëpadia e paditësit në emër të fitimit pabazë është e bazuar, dhe si e tillë duhet të aprovohet në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe detyrohet e paditura që shumën e tërhequr të mjeteve t'ia kompensoi paditësit, pasi që ka vepruar, në kundërshtim me kontratën e nënshkruar nga paditësi dhe e paditura si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë".*

68. Më tej, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1986/2020] kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ku në arsyetimin e aktgjykimit të saj, ndër të tjera, theksoi:

*"Nga shkresat e lendes gjithashtu shihet se e paditura ka bere tërheqjen e mjeteve nga llogaria bankare e paditësit ne shumen prej 1,953.36€ me date 28.03.2013, e qe kolegji vlerëson se nuk janë përfillur procedurat ligjore përmes organit kompetent-gjykatës kompetente për ekzekutimin, sekuestrimin dhe shitjen e kolateralit qe do duhej te merreshin parasysht, ne rast te mos përmbushjes se kredisë nga garantuesi solidar.*

*Nga një gjendje e tille e çështjes, kolegji vie ne përfundim se e paditura është pasuruar pa baze ligjore, duke mos respektuar dispozitat ligjore dhe marrëveshjen mbi kredinë nr.200620647 te datës 20.10.2006, ku ne nenin 10 pika k), është parashikuar se: "Ne rast se kredi marrësi nuk respekton marrëveshjen, kredi dhënësi sipas dëshirës se tij te lire ka te drejte për dëmshpërblim kompensim te mëposhtme, duke iniciuar procedurën e përmbarimit me qellim te shitjes se kolateralit te lënë peng ose hipoteke për te përmbushur obligimet e pa paguara nga kjo marrëveshje dhe marrëveshjes mbi hipotekën", ndërsa ne nenin 86 te LPP-se, esht:e përcaktuar se: "Përmbarimi për sendet e luajshme zbatohet me ane te regjistrimit, dhe vlerësimit te tyre, sekuestrimit, shitjes se sendeve dhe përmbushjen e kredisë se kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve. Me rastin e zbatimit te dispozitave te lartcekura, nga shumat e fituara me ane te shitjes përmbushet kredia e propozuesit te përmbarimit. Në nenin 99 te LPP-se është përcaktuar se: "Shitja e sendeve te sekuestruara behet me ane te ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejte midis blerësit, nga njëra ane dhe organi përmbarues, apo subjektit tjetër te autorizuar, nga ana tjetër". Kolegji ka refuzuar pretendimet ankimore të të paditurës, pasi ka gjetur !je, pasurimi i pa baze është një nder burimet materiale te se drejtës se detyrimeve, qe konsiston ne rritjen e pasurisë se një personi duke e zvogëluar pasurinë e personit tjetër pa baze te vlefshme juridike. Kolegji ka marre parasysht ekzistimin e te drejtës se kreditorit dhe qe paditësi ka pasur te përmbushë detyrimin ndaj paditësit, por kolegji ka vlerësimin se mënyra e realizimit te kredisë duhet te behet ne rruge ligjore ne procedurën e parapare me ligj dhe nuk mundet qe te behet duke i anashkaluar procedurat e tilla. Kolegji gjen se, gjykata e shkalles se pare ne arsyetimin e vendimit gjyqësor ka dhënë arsye te plota lidhur me mënyrën e vendosjes duke u mbështetur ne provat e nxjerra, dhe ka vërtetuar se ekziston pasurimi i pa baze i te paditurës".*

69. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit duke u mbështetur në nenin 319.1 të LPK-së, në esencë theksoi se palët ndërgjyqëse, e kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat bazohen kërkimet dhe pretendimet e veta, e të cilat parashtruesja e kërkesës ka dështuar t'i provojë. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit, konstatoi se parashtruesja e kërkesës në procedurën e zhvilluar dhe në pretendimet e parashtruara në ankesë nuk kishte arritur t'i mbështesë ato, dhe për këtë edhe ankesa e saj ishte refuzuar si e pathemeltë dhe ishte refuzuar.
70. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesja e kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
71. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysht pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk

karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

### **Përfundim**

72. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet e saj:

(i) Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit, bien në kategorinë e pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe rrjedhimisht janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

(ii) Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore, ato bien në kategorinë “*mungesë e dukshme ose evidente e shkeljes*”, dhe rrjedhimisht janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2023, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtarja raportues**

Remzie Istrefi Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani